

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 13
21.04.2015

NR. VENDIMI 10
23.04.2015

V E N D I M
“PËR SEKUESTRIMIN E PASURISË”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e përbërë nga :

Gjyqtar : Klodian KURUSHI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ermira TERBUNI**, sot më datë **23. 04. 2015, ora 09:00**, zhvilloi gjykimin e kërkesës penale që i perket;

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurorja Manjola KAJANA**.

KUNDËR : Pasurive të shtetasit Sh.B.

OBJEKTI : a) Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme si më poshtë vijon:

- Objekti truall me nr. pasurie me sip.parcele ndërtimore xxx m2 z.k xxx, Lagja “xxx” xxx, me pronar Sh.B.
- Objekti ndërtesë xxx kate me sip.totale xxx m2, me nr. pasurie xxx, z.k.xxx, Lagja “xxx” xxx, i regjistruar në emër të shtetasit Sh.B.
- Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet z. E.B. i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave xxx.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat, dëgjoi diskutimin përfundimtar të prokurorit i cili kërkoi:

Sekuestrimin e pasurive sipas objektit të kërkesës. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluatshme të ngarkohet z. E.B. i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave xxx si dhe për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.

V Ë R E N:

Prokuroria Për Krime të Rënda xxx për procedimi pasuror nr.xxx datë xxx ka filluar mbi bazën e referimit të bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxx, me shkresën nr. xxx prot xxx, e cila heton procedimin penal nr.xxx të vitit xxx për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E.B.

Sipas informacioneve të mbledhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut xxx ka rezultuar se shtetasit E.B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B.B. dhe E.M.), i biri xxx., i datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe I.K. (I. B.), i biri i xxx, i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx, kanë kryer investime në fushën e ndërtimit si dhe transaksione me shuma të konsiderueshme, të cilat dyshohen se janë produkt i aktivitetit kriminal të ushtruar prej tyre. Konkretisht, nga të dhënat e deritanishme ka rezultuar se shtetasi E.B. (B.) dhe i ndjeri, vëllai i tij I.K. (i cili ka gjetur vdekjen në muajin xxx të vitit xxx) kanë ndërtuar një godinë xxx-katëshe në Lagjen ”xxx” xxx, me destinacion resort turistik.

Ka rezultuar se, me lejen nr.xxx datë xxx, shtetasi Sh.B., i ati i xxx dhe E. B., është pajisur me leje legalizimi për objektin me nr.pasurie xxx, z.k.xxx me sipërfaqe parcele ndërtimore xxx m², sipërfaqe totale ndërtimi xxx m², numri i kateve mbi tokë x. Lidhur me këtë sipërfaqe trualli rezulton se, me kontratën noteriale të kaparit nr.xxx rep., nr.xxx kol., datë xxx, shtetasi Sh. B., në cilësinë e blerësit ka blerë nga trashëgimtarët e Sh.G. këtë truall në vlerën xxx euro. Në kontratë përcaktohet se shitësi ka paguar këstin e parë prej xxx euro, ndërsa shuma prej xxx euro do të paguhet më datë xxx.

Nga organi procedues është bërë kqyrja e vendit të ngjarjes, konkretisht e objekti të ndërtuar, të cilës i është bashkëlidhur tabela fotografike nr.xxx datë xxx.

Gjithashtu është proceduar me ekspertimin vlerësues të kësaj pasurie dhe nga akti i ekspertimit vlerësues të kësaj pasurie konkludohet se, vlera e objektit të vlerësuar sipas kostos së ndërtimit për qytetin e xxx, në momentin e inspektimit ku objekti nuk është përfunduar por është realizuar në 82.2 % të volumit të ndërtimit ka vlerën xxx lekë. Konstatohet se punimet brenda në godinë nuk kanë përfunduar. Po ashtu në vlerën e kosotos nuk është përfshirë vlera e truallit.

Në deklarimin e tij, shtetasi Sh.B. ka deklaruar se, kjo pasuri është investim i të afërmeve të tij, konkretisht djemve të tij A.B., E.B. dhe I. K. që nuk jeton më, ku secili ka vendosur të ardhura. Burime të këtyre të ardhurave janë siguruar nga shitja e bagëtive të imëta që Sh.B. ka patur për periudhën xxx-xxx, si dhe të ardhurat e fituara nga puna në emigrim e djemve të tij që në vitet 'xxx. Lidhur me truallin ku është ndërtuar objekti, ai shpjegon se djali i tij I.K. e ka blerë nga M.G. Me sa ka dijeni nga i ndjeri I.K., vlera e objektit ka shkuar rreth xxx (xxx) lekë. Ai shpjegon se në muajin dhjetor të vitit xxx është pajisur me çertifikatë pronësie për këtë objekt. Po ashtu shpjegon, se në vitet xxx-xxx djali i tij I. ka qenë në burg në xxx ose xxx për rreth dy vjet.

Në deklarinimin e tij shtetasi E. B. ka shpjeguar se, që nga viti xxx ka punuar si emigrant në xxx. Në Shqipëri ka patur një depozitë në vlerën xxx euro në xxx Bank. Ai nuk ka qenë asnjëherë i punësuar në Shqipëri por të ardhurat i ka siguruar nga puna e tij jashtë shtetit. Ai është arrestuar në xxx në vitin xxx, ku ka bërë 6 muaj burg. Po ashtu dhe vëllezërit e tij kanë qenë të arrestuar jashtë shtetit.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë xxx është kryer hetimi pasuror në lidhje me verifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive në

emër të shtetasve të mësipërm si dhe për familjarët e tyre dhe nuk ka rezultua që këta persona të kenë realizuar të ardhura të ligjshme që të justifikojnë burimin e ligjshëm të investimit të kryer.

Ka rezultuar se në emër të I.K. është rregjistruar shoqëria tregtare “xxx” shpk, por kjo shoqëri tregtare rezulton se është regjistruar në datën xxx, në kohën që ndërtimi i objektit ka përfunduar.

Nga informacioni i marrë nga Zyra Ndërlidhëse Interforce xxx është bërë me dije se I.K.(B.) është arrestuar në flagrancë në vitin xxx për trafikim të lëndëve narkotike dhe armëmbajtje pa leje. Rezulton se, më datë xxx në ngarkim të I.K. është lëshuar një mandat arresti për deklarinim të rremë në lidhje me identitetin. Gjithashtu, më datë xxx, ky person është arrestuar në flagrancë për trafik të lëndëve narkotike dhe armëmbajtje pa leje. Më datë xxx është liruar nga burgu me anë të Urdhrit nr.xxx të datës xxx të Prokurorisë së Republikës në xxx.

Në vijim, ndaj shtetasit I.K. është dhënë masa e sigurisë “Arrest në burg” xxx, e datës xxx nga Gjykatësi i Hetimeve Paraprake pranë Gjykatës në xxx në kuadër të procedimit penal nr.xxx xxx xxx për trafik lëndësh narkotike. Gjykatësi i Hetimeve Paraprake pranë Gjykatës në xxx ka lëshuar masë sigurie “Arrest në burg” nr.xxx - Nr.xxx xxx si dhe ka kërkuar një mandat arresti europian për shkelje të neneve 73-74 xxx dhe nenit 4 të ligjit 146/2006. Bëhet me dije se më datë xxx, ky shtetas është liruar nga burgu pasi Prokurori i Përgjithshëm pranë Gjykatës së Kasacionit xxx ka urdhëruar mbylljen e

menjëhershme të masës së sigurisë ”Arrest me burg”.

Gjithashtu në informacionin e dërguar nga Zyra Ndërlidhëse Interforce xxx rezulton se ndaj I.K. më datë xxx është caktuar masa e sigurisë ”Arrest në burg” në vijim të ekstradimit në xxx.

Gjithashtu nga të dhënat e këtij hetimi ka rezultuar se shtetasi E.B. ka qenë i proceduar nga autoritetet e drejtësisë në xxx, ku ka qenë edhe i arrestuar për vepra penale të kryera në fushën e narkotikëve.

Më datë xxx nga ana e organit procedues xxx është proceduar me regjistrimin e emrit të E.B. si person nën hetim për veprën penale të ”Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Për sa më lart, kur për shtetasin E.B. ka të dhëna dhe dyshime se është e përfshirë në aktivitetin kriminal të ”Trafikimit të narkotikëve”, dhe ai dyshohet për veprën penale të ”Pastrimit të Produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në kushtet kur edhe kompania ”xxx” shpk, shoqëri tregtare rezulton të jetë regjistruar në datën xxx, pra pasi objekti i ndërtuar nga shtetasi E.B. dhe vëllai i tij i ndjeri I.B., shtetasi E.B. është subjekt i hetimit pasuror, bazuar në nenin 3 pika 1/d të Ligjit ”Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Për këtë shtetas nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx janë identifikuar dhe është vendosur masa e sigurimit pasuror ”Sekuestro preventive” nga ana e Gjykata e Shkallës së Parë xxx me vendimin nr. xxx date xxx mbi keto pasuri:

- Objekti truall me nr. pasurie me sip.parcele ndërtimore xxx m2 z.k xxx, Lagja ”xxx” xxx, me pronar Sh.B.
- Objekti ndërtesë xxx kate me sip.totale xxx m2, me nr. pasurie xxx, z.k.xxx, Lagja ”xxx” xxx, i regjistruar në emër të shtetasit Sh.B.

Përsa i përket pasurive të mësipërme rezulton se Objekti xxx katësh në zonën e

“xxx” është legalizuar me lejen e legalizimit nr. xxx datë xxx në emër të shtetasit Sh.S.B, babai i të dyshuarit E.B. Ndërsa trualli rezulton të jetë blerë sipas kontratës noteriale nr. xxx rep dhe xxx kol datë xxx nga trashëgimtarët e Sh.G, po nga shtetasi Sh.S.B., ku sipas vërtetimit hipotekor me nr. xxx dt xxx, ky truall që ndodhet në zonën kadastrale me nr. xxx dhe me sip xxx m2, rezulton të jetë regjistruar në emër të shtetasit Sh.B.

Nga verifikimi i kryer në Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme shtetasi E.B. nuk rezulton të ketë prona të regjistruara pranë këtyre zyrave.

Të gjitha këto pasuri dyshohet se janë fituar nga të ardhurat e realizuara si rezultat i veprimtarisë kriminale të kryer jashtë shteti nga personi i hetuar E. (B.) B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.), i biri xxx, i datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe i ndjeri vëllai i tij I.K. (I.B.), i biri i xxx, i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx.

Gjithashtu nga hetimi është provuar se këta të fundit dhe familjarët e tyre nuk kanë të ardhura të cilat mund të justifikojnë një pasuri të tillë.

Sa më sipër këto pasuri plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi së pari janë përfituar pas përfshirjes së personit në veprimtari kriminale.

Së dyti, këto pasuri nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave të të dyshuarve dhe familjarëve të tyre.

Së treti, ekziston rreziku i humbjes apo tjetërsimit pasi ndaj vendimit të sekuestrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, mund të ankohen të interesuarit duke kërkuar revokimin apo moskonfiskimin e këtyre pasurive.

Nga sa më sipër rezultoi nga aktet e provat shkresore, sa vijon;Urdhër për regjistrimin e procedimit pasuror nr.xxx të datës xxx,shkresa nr.xxx datë xxx për fillimin e procedimit pasuror të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor

xxx,urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë xxx (si dhe dy urdhëra delegimi datë xxx, xxx,urdhër për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale datë xxx,Shkresa e DPQ xxx me nr xxx prot datë xxx dhe ajo me nr. xxx dt xxx, si dhe informacionet për referimin e vp dt xxx, si dhe verifikimet e para të kryera nga polica gjyqësore,shkresa nr. xxx prot datë xxx e Drejtorisë për krimin ekonomike financiar xxx,shkresë nr. xxx prot datë xxx e Inspektoriatit ndërtimor dhe Urbanistik bashkëngjitur praktika e këtij inspektoriatit për objektin në ndërtim në zonën e xxx nga shtetasi I. B.,shkresa me nr. xxx prot datë xxx e DPQ xxx,shkresa me nr.xxx prot datë xxx e Drejtorisë për Krimin Ekonomik e Financiar, pranë DPP Shtetit,shkresë me nr. xxx datë xxx e Zyrës Ndërlidhëse të Interforcës në xxx,Shkresa me nr. xxx prot datë xxx e DPQ xxx,vendim i prokurorit datë xxx Për sekuestrimin e dokumentave (praktikat e dërgesa nga xxx”, si dhe aktet për ekzekutimin e këtij vendimi,kthim përgjigje nga xxx nr. xxx prot datë xxx,shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së parë xxx drejtuar të gjitha Bankave të nivelit të dytë për transaksionet e kryera nga i dyshuari dhe personat e lidhur me të,kthim përgjigjet e Bankave të nivelit të dytë, sipas renditjes në fashikullin e procedimit pasuror, duke filluar nga Banka xxx duke përfunduar me përgjigjen e Bankës xxx,shkresa me nr. xxx prot datë xxx e Drejtorisë rajonale tatimore xxx,shkresa me nr. xxx prot datë xxx e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,shkresa me nr. xxx prot datë xxx e Drejtorisë së përgjithshme të transportit rrugor;praktika e QKR për kompaninë xxx shpk,shkresa me nr. xxx prot datë xxx e QKL,shkresa me nr.xxx prot datë xxx e Drejtorisë rajonale tatimore xxx,shkresa të Zyrave të ndryshme Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme (të qyteteve të ndryshme nga të cilat nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të shtetasve në hetim),Proces verbal për këqyrje e marrje të dokumentave datë xxx me aktet bashkëngjitur për praktikën e lejes së legalizimit,shkresa me nr. xxx prot datë xxx e ALUIZNIT me kopjen e materialit për objektin e legalizuar nga subjekti Sh.B.,vendim për këqyrjen e vendit të ngjarjes datë xxx dhe prc për këqyrjen e vendit të ngjarjes datë xxx si dhe fotot bashkëlidhur,vendim për kryerjen e ekspertimit vlerësues datë xxxx dhe akti i ekspertimit datë xxx, Kërkesë për caktimin e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive datë xxx,Vendimi nr.xxx datë xxx

(Shkurtim Vendimi) mbi vendosjen e sekuestros preventive i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx (shkurtim i vendimit), urdhëri i prokurorit datë xxx për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, letërporosi drejtuar Autoriteteve xxx të drejtësisë, letërporosi drejtuar Autoriteteve të xxx së xxx, proces verbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi Sh.B., E.B. (B.), të paraqitura nga organi i prokurorisë në seancë gjyqësore.

Bazuar në rrethanat dhe prova të mësipërme, gjykata çmon se kërkesa e prokurorisë për sekuestrimin e pasurive të kërkuara nga ana e saj gjendet e bazuar në ligj dhe do të pranohet, pasi personat që disponojnë këto pasuri, po hetohen për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar si krim nga neni 278 i K. Penal dhe natyra e kësaj veprë penale krijon indicje të mbeshtetur në provat e përmendura më lart, se ato janë krijuar i rezultat i aktivitetit të paligjshëm në fushën transaksioneve që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale.

Në përfundim të këtij gjykimi, gjykata konkludon se duke u bazuar në provat e shqyrtuara dhe të analizuara më lart, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje se, personi ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për sekuestrimin e pasurive, dyshohet se janë përfshirë në veprimtari kriminale, nga ato që parashikon pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009. Ata zotërojnë pasuri të përshkruara më lart të cilat dyshohet se rrjedhin nga kjo veprimtari e kundërligjshme për të cilën ata po hetohen.

Nga provat e shqyrtuara gjykata çmon se ekziston një rrezik real për humbje, marrje, transferim apo tjetërsim të pasurive, ndaj të cilave mund të zbatohet në të ardhmen masa e konfiskimit, në qofte se këto pasuri nuk do të sekuestrroheshin nga kjo gjykate, në përputhje me procedurat e parashikuar nga ky ligj.

Sendet e kërkuara për sekuestrim janë gjithashtu të sekuestruara me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx për llogari të procedimit penal të nisur prej saj ndaj këtyre personave. Bazuar në nenin 5/3 të ligjit 10 192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masa Parandaluese kundër Pasurisë”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 3, 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

V E N D O S I

– **Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme, si më poshtë vijon:**

- Objekti truall me nr. pasurie me sip.parcele ndërtimore xxx m² z.k xx, Lagjia “xxx” xxx, me pronar Sh.B.
- Objekti ndërtesë x kate me sip.totale xxx m², me nr. pasurie xxx, z.k.xxx, Lagja “xxx” xxx, i regjistruar në emër të shtetasit Sh.B.
- Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme ngarkohet z.E.B.,i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave xxx.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes për palen e pranishme, ndersa për palët në mungesë, ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni për vendimin.

U shpall në Tiranë më datë 23. 04. 2015.

SEKRETARE

Ermira TERBUNI

GJYQTARI

Klodian KURUSHI

